

BANKINGU QENDROR

AKTIVITETET KRYESORE
TË BANKËS SË SHQIPËRISË
Janar - Qershor 2024



LAJME DHE
NGJARJE
NË 6 MUAJ

Nr. 15





Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko.

EDITORIAL

Të nderuar Lexues,

Gjashtëmuajori i parë i këtij viti shënoi një ngjarje të rëndësishme në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë dhe jo vetëm. Në 12 qershor, Banka e Shqipërisë dërgoi pranë Këshillit Evropian të Pagesave (EPC), aplikimin zyrtar të Republikës së Shqipërisë për përfshirjen në zonën gjeografike të skemave SEPA. Tregu Unik i Pagesave në Euro (SEPA) është një iniciativë e Bashkimit Evropian (BE) për të harmonizuar pagesat në Euro në vendet e BE-së. Megjithatë, ndër vite, ky treg është shtrirë edhe jashtë BE-së, duke numëruar aktualisht 36 shtete anëtare. Qëllimi i funksionimit të SEPA-s është t'i bëjë pagesat në Euro midis vendeve anëtare po aq të thjeshta dhe të lira sa ato vendase, duke krijuar një treg të vetëm për to.

Anëtarësimi i Shqipërisë në SEPA është një mundësi për të integruar platformat e kryerjes së pagesave në Euro dhe të tregtisë elektronike me tregun evropian, përpara anëtarësimin tonë në BE. Në nëntor 2023, Komisioni Evropian miratoi Planin e Ri të Rritjes 2024-2027 (New Growth Plan for Western Balkans), ku anëtarësimi i përshtetur i Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në SEPA listohet si një nga objektivat kryesorë. Në këtë kontekst, anëtarësimi në SEPA është tashmë prioritet kombëtar. Ndonëse procesi i aplikimit u udhëhoq nga Banka e Shqipërisë, ai është fryt i bashkëpunimit dhe ka mbështetjen e plotë të Qeverisë Shqiptare.

Nga ky anëtarësim pritet të krijohen lehtësira për bizneset dhe konsumatorët shqiptarë, duke i bërë transaksionet financiare ndërkufitare me vendet e tregut evropian më të thjeshta, më të shpejta dhe me kosto më të ulëta. Me pjesëmarrjen në SEPA mundësohet zbatimi i parimit të tarifave të barabarta si për pagesat kombëtare, ashtu edhe ato ndërkufitare të përpunuara në mënyrë elektronike në Euro.

Gjithashtu, transfertat brenda anëtarëve të SEPA-s bëhen pa pasur nevojën e bankave ndërmjetëse, duke rritur thjeshtësinë dhe efikasitetin e tyre. Me kryerjen e transfertave nëpërmjet SEPA-s, kostoja e pagesave ndërkufitare në Euro me vendet anëtare është rreth 5 herë më e ulët. Përfitimet ekonomike nga kryerja e pagesave me efikasitet më të lartë sa i përket kostove, kohës dhe sigurisë janë të mëdha, dhe, sipas vlerësimeve tona, mund të arrijnë deri në 20 milionë euro në vitin e parë, për t'u rritur në vijim.

Duke pasur parasysh se BE-ja është partner tregtar kryesor i Shqipërisë dhe në kushtet kur rreth 60% e tregtisë kryhet me vendet e BE-së, përfitimet nga krijimi i lehtësirave financiare janë domethënëse për zgjerimin e shkëmbimeve tregtare. Pjesëmarrja në SEPA i ofron bizneseve shqiptare qasje në tregun evropian prej 350 milionë banorësh, duke iu mundësuar zgjerimin e aktivitetit të tyre, rritjen e konkurrencës e të fitimeve.

Pjesëmarrja në SEPA vlerësohet se do të ketë një kontribut domethënës edhe në sektorin strategjik të turizmit, duke i dhënë mundësi turistëve evropianë të kryejnë pagesat në Shqipëri më shpejt dhe me kosto më të ulët. Gjithashtu, pritet që anëtarësimi të ndikojë në rritjen e flukseve të lidhura me investimet e huaja direkte, si dhe në formalizimin e flukseve të remitançave, për shkak të uljes së kostove të dërgimit të tyre.

Nga pikëpamja e zhvillimit të mëtejshëm të tregut të pagesave dhe impaktit që ato kanë në funksionet e tjera të bankës qendrore dhe në ekonomi, pjesëmarrja në SEPA ofron një mënyrë për të adoptuar sisteme më moderne dhe më të sigurtat pagesash elektronike. Duke prezantuar alternativa të tilla për qytetarët shqiptarë synohet: rritja e përdorimit të pagesave elektronike,

ulja e përdorimit të parasë fizike dhe rritja e përfshirjes financiare.

Kriteret për zgjerimin e shtirjes gjeografike të SEPA-s janë përcaktuar dhe vlerësohen nga EPC-ja, me dakordësinë e Komisionit Evropian. Ato fokusohen në pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së për pagesat, ku Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm. Kjo arritje është rezultat i përpjekjeve disavjeçare për modernizimin e tregut vendas të pagesave me vlerë të vogël, nëpërmjet Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël (2018-2023), dhe vijim i projektit rajonal të Bankës Botërore "Për modernizimin e sistemeve të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor". Në kuadër të këtyre iniciativave janë prezantuar ndryshime

ligjore thelbësore për përafrimin e legjislacionit, të tilla si transpozimi i Direktivës për Shërbimet e Pagesave (PSD2), i Direktivës së Llogarisë së Pagesave dhe i rregullores së SEPA-s. Një zhvillim mjaft i rëndësishëm në lidhje me aplikimin e BSH-së ka qenë dhe dalja e Shqipërisë nga "lista gri" e pastrimit të parave, një kriter thelbësor ky për pjesëmarrjen në SEPA.

Dorëzimi i aplikimit ishte një hap i parë dhe thelbësor drejt realizimit të këtij objekti kombëtar. Megjithatë, puna dhe përpjekjet do të vijojnë si gjatë shqyrtimit të aplikimit ashtu edhe në kuadër të udhëheqjes së aktorëve të tregut për t'u bërë pjesë e skemave të SEPA-s, çka do të mundësojë materializimin e plotë të efekteve të këtij projekti.

ZHVILLIMET KRYESORE


BANKA E SHQIPËRISË FIRMOS APLIKIMIN ZYRTAR PËR ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË SEPA

Më 12 qershor 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, firmosi aplikimin e Republikës së Shqipërisë për anëtarësimin në zonën gjeografike të skemave SEPA. Duke shënuar një ditë historike jo vetëm për sistemin financiar në vend, por për të gjithë qytetarët shqiptarë.

SEPA është një iniciativë e hershme e Bashkimit Evropian për harmonizimin e pagesave elektronike në Euro, ndërmjet vendeve anëtare. Skemat e Pagesave SEPA i sigurojnë qytetarëve dhe bizneseve evropiane, pagesa ndërkufitare në monedhën e përbashkët, me të njëjtën kosto dhe lehtësi si pagesat brenda vendit të tyre.

Banka e Shqipërisë ka nisur punën për anëtarësimin e Shqipërisë në SEPA që në vitin 2021, kur u bë pjesë e projektit rajonal "Për modernizimin e sistemeve të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor". Ky projekt e ka origjinën nga marrëveshjet e Procesit të Berlinit dhe synon zhvillimin e marrëdhënieve financiare dhe ekonomike midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe njëkohësisht integrimin e rajonit në Bashkimin Evropian. Në nëntor të vitit 2023, Komisioni Evropian shpalli planin e ri për rritjen e Ballkanit Perëndimor, ku një nga prioritetet është pikërisht pjesëmarrja e vendeve të rajonit në SEPA, duke i dhënë kështu rajonit mundësinë të përshpejtojë integrimin ekonomik në tregun unik evropian edhe përpara anëtarësimin të tij në Bashkimin Evropian.

Kjo e bën Shqipërinë vendin e parë në rajon që dërgon aplikimin formal për t'u pranuar në zonën gjeografike SEPA. Pjesëmarrja e Shqipërisë në SEPA, jo vetëm që shënon një hap mjaft të rëndësishëm në rrugëtimin e integritit evropian të vendit, por do të krijojë lehtësira për bizneset dhe konsumatorët shqiptarë në terma të kostos, kohës dhe thjeshtësisë me të cilën do të kryejnë transaksione ndërkufitare brenda tregut evropian.



GUVERNATORI SEJKO NË FORUMIN PËR VENDET E EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE, TË ORGANIZUAR NGA "EUROMONEY" 16-17 janar 2024, Vjenë, Austri

Në datat 16-17 janar 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit ekonomike dhe kryesisht ato të rajonit lindor dhe juglindor të saj. Në panelin pjesë e të cilit ishte Guvernatori Sejko, u shkëmbyen mendime mbi disa çështje kryesore të aktualitetit ekonomik, të tilla si: sfidat që shtrohen përpara ekonomive të rajonit nga rritja e inflacionit dhe reagimi i bankave qendrore ndaj tij; rifitimi i besueshmërisë së institucioneve dhe mjetet e reja të komunikimit; si dhe sfidat afatgjata që shtrohen lidhur me zhvillimet teknologjike dhe ndërlihdja e tyre me politikën monetare.



Guvernatori Sejko shprehu pikëpamjet e tij mbi pasojat e zhvillimeve ekonomike në rajon, si përballja me inflacionin pas goditjes globale të furnizimit të shkaktuar nga lufta në Ukrainë. Ai theksoi se kostot për aktivitetin ekonomik kanë qenë mjaft të dukshme, madje disa ekonomi si Eurozona rrezikuan të kalonin në recesion. Më tej, ai u ndal në rastin e Shqipërisë, ku është arritur reduktimi

i inflacionit nga piku prej 8.3% në nëntor 2023, në nivelin prej 4% në dhjetor 2023. Në të njëjtën kohë është siguruar dhe ruajtja e një rritjeje ekonomike solide prej rreth 3.5% për vitin 2023. Ai shtoi se Banka e Shqipërisë ka ndjekur një cikël normalizimi të qëndrimit të politikës monetare gjatë vitit 2023, duke e rritur normën bazë të interesit deri në nivelin 3.25%.



Guvernatori theksoi se aktualisht jetojmë në një botë me përparim të shpejtë teknologjik dhe industria financiare nuk është e përjashtuar prej tij. Përdorimi i "big data",

inteligjencës artificiale, monedhave digjitale dhe inovacioni i sistemeve të pagesave kanë sfiduar praktikat dhe politikat ekzistuese të bankave qendrore.

PREZANTOHET RAPORTI I TRANZICIONIT TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM 2023-2024

29 janar 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 29 janar 2024, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u prezantua Raporti i Tranzicionit i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), 2023-2024.

Në fjalën përshëndetëse, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, u shpreh se Raporti i Tranzicionit të BERZH-it hap siparin e analizave profesionale ekonomike për vitin 2024; konkluzionet e rekomandimet e tij shtojnë përpara debatin ekonomik, jo vetëm mbi sfidat e kohës, por edhe mbi politikat e duhura zhvillimore në funksion të një rritjeje sa më të shpejtë e të qëndrueshme. Në këtë kontekst, Guvernatori Sejko u shpreh se për Bankën e Shqipërisë është kënaqësi ta mirëpresë këtë aktivitet të përvitshëm që bën bashkë studiues të fushës, aktorë të rëndësishëm të sektorit publik e privat, si dhe përfaqësues të industrisë financiare.



“Tema e raportit – “Tranzicionet e mëdha dhe të vogla” - na fton të hedhim vështrimin më larg. Cilësia e jetës dhe faktorët që e ndikojnë atë, realitetet e reja gjeopolitike dhe pasojat e tyre mbi strategjitë e zhvillimit të vendeve në tranzicion, ndryshimet klimatike, ngrohja globale dhe reduktimi i biodiversitetit, janë realitete të pamohueshme e me pasoja të konsiderueshme, jo vetëm për ekonominë, por edhe për shoqërinë e komunitetet tona.” - u shpreh Guvernatori.



Përpjekjet e Bankës së Shqipërisë janë përqendruar në tre drejtime kryesore:

- së pari, në monitorimin e rreziqeve klimatike dhe zgjerimin e kapaciteteve analitike në këtë fushë;
- së dyti, në promovimin e financave të gjelbra. Për këtë qëllim, banka ka miratuar së fundmi “Strategjinë për Menaxhimin e Rreziqeve Financiare të lidhura me Ndryshimet Klimatike, 2023-2025”;
- së treti, në forcimin e bashkëpunimit me partnerët vendas dhe të huaj. Adresimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike dhe tranzicioni drejt një ekonomie të qëndrueshme janë sfida globale.

BANKA E SHQIPËRISË, NË BASHKËPUNIM ME BANKËN BOTËRORE, ORGANIZOJNË WORKSHOP-IN “MODERNIZIMI I SISTEMEVE TË PAGESAVE NË SHQIPËRI”

8-9 shkurt 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datat 8-9 shkurt 2024, në ambientet e Bankës së Shqipërisë u zhvillua *workshop*-i me temë “Modernizimi i sistemeve të pagesave në Shqipëri”. Punimet e tij u përshëndetën nga Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, e cila theksoi rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e sistemit të pagesave me Bankën Botërore dhe institucionet e tjera ndërkombëtare të fushës.



Zj. Minxhozi u shpreh se Banka e Shqipërisë, së bashku me Bankën Botërore, BE-në dhe Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal,

ka intensifikuar përpjekjet në drejtim të tre prioritetëve kryesore të punës sonë në fushën e sistemeve të pagesave, të tilla si: implementimi i ligjit “Për shërbimet e pagesave” (PSD2), pjesëmarrja në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA) dhe ndërtimi i *Instant Payment*.



Përfaqësuesi i Bankës Botërore (BB), z. Holti Banka, Ekspert i lartë në sektorin financiar, përshëndeti punën e bërë nga Banka e Shqipërisë në drejtim të krijimit të kuadrit të plotë rregullator për zbatimin e ligjit “Për shërbimet e pagesave”. Ai theksoi se BB-ja po mbështet të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor për përafrimin e standardeve në fushën e pagesave me ato të Bashkimit Evropian. Në veçanti, ai theksoi avantazhet e pjesëmarrjes në SEPA për këto vende.

MBAHET PËR HERË TË PARË NË SHQIPËRI MBLEDHJA E KONSTITUENCËS SË FMN-SË DHE BB-SË

16 shkurt 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 16 shkurt 2024, në ambientet e Bankës së Shqipërisë u zhvillua Mbledhja e Konstituencës së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Grupit të Bankës Botërore (BB). Ky takim i organizuar për herë të parë në Shqipëri nën kujdesin e Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave,

mbledhi së bashku guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare të kësaj konstituence.



pabarazisë, si dhe hapat e ndërmarra për t'i trajtuar këto probleme, duke synuar rritjen e qëndrueshme të ekonomive të vendeve.



Takimi u përshëndet nga Kryeministri i Shqipërisë, SH.T.Z. Edi Rama, dhe në nisje të punimeve mbajtën fjalë: Ministri i Financave, z. Ervin Mete; Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko; Drejtori Ekzekutiv për Shqipërinë në FMN, z. Federico Giammusso; dhe Drejtori Ekzekutiv për Shqipërinë pranë Bankës Botërore, z. Matteo Bugamelli.

Në fokus të kësaj mbledhjeje ishin sfidat aktuale me të cilat po përballen ekonomitë e këtyre vendeve dhe përjashtet sa më eficiente dhe të koordinuara me qëllim zhvillimin e tyre. Përfaqësuesit e lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) prezantuan perspektivat e këtyre dy institucioneve lidhur me sfidat globale si: luftërat dhe konfliktet, rritja e frekuencave të fatkeqësive natyrore, shtimi i varfërisë dhe

Gjatë fjalës së tij, Guvernatori u shpreh se viti 2023 për Shqipërinë u mbyll me një rritje ekonomike rreth nivelit 3.5%, me një normë papunësie në minimume historike, si dhe me një borxh të huaj, borxh publik dhe tregues të kredive me probleme, poshtë niveleve të regjistruara përpara goditjeve. Në veçanti, inflacioni u përgjysmua gjatë vitit të shkuar, duke zbritur në nivelin 4%, ndërsa treguesit e shëndetit të sektorit bankar mbetën pozitivë.

Ndër të tjera, Guvernatori nënvizoi se banka qendrore duhet ta çojë deri në fund luftën kundër inflacionit. Trendi rënës i tij është lajm i mirë, por një inflacion në rënie nuk është një inflacion në objektiv. Prandaj, bankat qendrore duhet të vijojnë të fokusohen në marrjen e masave të nevojshme për kthimin e inflacionit në objektiv, si parakusht për rritjen e qëndrueshme të ekonomive dhe të mirëqenies së qytetarëve.

MINISTERIALI "BALLKANI PERËNDIMOR DREJT TREGUT UNIK TË PAGESAVE NË EURO (SEPA)"

28 shkurt 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 28 shkurt 2024, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u zhvillua Ministeriali "Ballkani Perëndimor drejt Tregut Unik të Pagesave në Euro (SEPA)", organizuar



nga Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë. Ai u mbajt në prag të Samiit të Liderëve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së për Planin e Rritjes, në të cilin Komisioni Evropian ka identifikuar aksesin në SEPA (Single Euro Payments Area), si një nga mundësitë që i ofrohet vendeve të Ballkanit Perëndimor përpara finalizimit të procesit të anëtarësimit, me përbushjen e kushteve të përcaktuara. Në Ministerial morën pjesë ministrat e financave dhe guvernatorët e bankave qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe përfaqësues të Komisionit Evropian, Bankës Botërore dhe BERZH-it.



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në fjalën e tij theksoi rëndësinë e integritit ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian dhe faktin që ky integrim, ndër të tjera, po ndodh nëpërmjet sistemeve të pagesave, i kurorëzuar me pjesëmarrjen e përsheptuar në SEPA.

Në këtë drejtim, Shqipëria ka intensifikuar përpjekjet për arritjen e këtij objektiv historik,



duke synuar ta përfundojë procesin e aplikimit për pjesëmarrjen në SEPA, brenda muajit qershor 2024. Përtej angazhimit serioz në kuadër të procesit të integrit, vendi ynë ka treguar kujdes të veçantë në ndjekjen e parimeve dhe standardeve të Bashkimit Evropian për rregullimin dhe reformimin e tregut të pagesave. Si rezultat, bazuar edhe në konstatimet e Bankës Botërore, e cila është pjesë integrale dhe e rëndësishme e këtij projekti, Shqipëria vlerësohet e përparuar në këtë proces dhe është gati për të dorëzuar aplikimin për anëtarësimin në SEPA.

VIZITË ZYRTARE E GUVERNATORIT SEJKO NË BANKËN E ITALISË 13 mars 2024, Romë, Itali

Në datën 13 mars 2024, me ftesë të Guvernatorit të Bankës së Italisë, Guvernatori Gent Sejko kryesoi delegacionin e nivelit të lartë të Bankës së Shqipërisë, në një vizitë zyrtare pranë Bankës së Italisë, në kuadër të marrëdhënieve të shkëlqyera mes dy bankave qendrore dhe zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit teknik në fusha të ndryshme.



Gjatë vizitës, Guvernatori Sejko u prit nga Guvernatori i Bankës së Italisë, z. Fabio Panetta, si dhe zhvilloi takime të rëndësishme me drejtues të tjerë të këtij institucioni.

Fillimisht, Guvernatori Sejko e uroi homologun Panetta për marrjen e detyrës së Guvernatorit të Bankës së Italisë dhe u shpreh besimplotë se gjatë mandatit të tij, bashkëpunimi midis dy institucioneve do të vijojë të forcohet edhe më tej.



Guvernatori u shpreh se aktiviteti i Bankës së Shqipërisë është orientuar drejt përbushjes së misionit dhe detyrave ligjore, si dhe jetësimit të angazhimeve të marra në strategjinë afatmesme të zhvillimit. Një ndër objektivat strategjike të Bankës së Shqipërisë është modernizimi i sistemeve të pagesave dhe më konkretisht, anëtarësimi në Tregun Unik të Pagesave në Euro, njohur ndryshe si SEPA, dhe zbatimi i projektit për pagesat e shpejta (*Instant Payment*), për të cilin Banka e Shqipërisë po bashkëpunon ngushtë me Bankën e Italisë dhe Bankën Qendrore Evropiane.

Ai shtoi se implementimi me sukses i projektit për pagesat e shpejta do të krijojë kushtet



për integrimin e sistemit të pagesave në vend me sistemin evropian TIPS (*TARGET Instant Payment Settlement*), si dhe mund të shërbejë potencialisht si një zgjidhje shembull dhe për vende të tjera të Ballkanit Perëndimor.



Nga ana tjetër, Guvernatori Panetta vlerësoi kontributin dhe rolin e rëndësishëm të Bankës së Shqipërisë në sigurimin e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit. Ai theksoi se politika monetare e ndjekur dhe masat e marra nga Banka e Shqipërisë kanë ndikuar që Shqipëria të ketë një ndër normat më të ulëta të inflacionit dhe një ndër normat më të larta të rritjes ekonomike në rajon. Gjithashtu, z. Panetta vlerësoi dhe iniciativat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare për uljen e borxhit publik të vendit, i cili ka shënuar dhe nivelin më të ulët të tij në më shumë se një dekadë.



Në përfundim, Guvernatori Sejko falënderoi Guvernatorin Panetta për bashkëpunimin e suksesshëm midis dy institucioneve, e

veçanërisht për asistencën e dhënë nga Banka e Italisë në projektet e përbashkëta të zhvilluara deri tani, në fushat kryesore të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë.

MBI TAKIMIN E GUVERNATORIT SEJKO ME PËRFAQËSUES TË BERZH-IT 25 mars 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 25 mars 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, priti në një takim përfaqësuesit e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kryesuar nga z. Piotr Jacek Szpunar, Drejtor Rajonal për Poloninë, Bullgarinë dhe Shqipërinë, si dhe zj. Ekaterina Solovova, Përfaqësuese Rezidente e BERZH-it në Shqipëri.



Fillimisht, Guvernatori Sejko vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera të vendit tonë me BERZH-in dhe i falënderoi përfaqësuesit e tij për kontributin e çmuar dhënë për Shqipërinë, si një ndër investitorët më me peshë, falë të cilit janë realizuar projekte shumë të rëndësishme për sistemin bankar.

Më tej, ai bëri një ekspozitë të zhvillimeve më kryesore ekonomike dhe financiare të vendit tonë gjatë viteve të fundit, duke

theksuar se pavarësisht goditjeve të tërmetit dhe pandemisë, pasigurive të shtuara dhe sfidave të ndryshme, si rritja e çmimeve, Shqipëria shënoi rimëkëmbje ekonomike mjaft të shpejtë. Një rol të veçantë për këtë pati koordinimi midis autoriteteve kryesore dhe masat e ndryshme, të cilat ndihmuan në kapërcimin e kësaj situatë me sa më pak efekte negative dhe mosndikimin afatgjatë në zhvillimin e vendit.



Gjatë takimit, përfaqësuesit e BERZH-it u ndalën në rëndësinë e rolit të Bankës së Shqipërisë në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, duke e cilësuar atë si një nga më të avancuarit në Ballkanin Perëndimor. Ata gjithashtu u shprehën se trendi forcues i kursit të këmbimit është në linjë me përmirësimet strukturore në balancat e jashtme të ekonomisë shqiptare. Në këtë kontekst, ata theksuan përfitimet që ka ekonomia shqiptare nga regjimi i lirë i kursit të këmbimit.

GUVERNATORI SEJKO MERR PJESË NË 5-VJETORIN E OTP BANK ALBANIA

26 mars 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 26 mars 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, ishte i ftuar në aktivitetin e zhvilluar nga OTP Bank Albania, me rastin e përvjetorit të 5^{të} të prezencës së kësaj banke në Shqipëri.



Në fjalën përshëndetëse, Guvernatori Sejko u shpreh se në vitin 2019, grupi OTP materializoi interesin e hershëm për të qenë pjesë e tregut shqiptar, në një kohë kur grupe të tjera bankare evropiane nuk e shihnin më me të njëjtin interes këtë treg. Më tej, ai theksoi se dhe pse vitet 2019 – 2021 ofruan kushte aspak të lehta për të bërë biznes, OTP-ja tejkaloj në mënyrë të shkëlqyer sfidat me të cilat u përball, madje në 2022, ambicia e saj mori formë me blerjen e Alpha Bank, duke u pozicionuar në mënyrë të qëndrueshme si



një nga 5 bankat e rëndësishme sistemike në Shqipëri.

Në përfundim, Guvernatori shprehu besimin që Banka OTP do të vijojë të kontribuojë në mbështetjen e iniciativave të Bankës së Shqipërisë dhe të rritjes ekonomike të vendit, duke shërbyer njëkohësisht si një "urë" për investimet dhe eksperiencat bashkëkohore evropiane.

GUVERNATORI SEJKO PRET NË NJË VIZITË ZYRTARE GUVERNATORIN E BANKËS KOMBËTARE TË KROACISË 28 mars 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 28 mars 2024, me ftesë të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, Guvernatori i Bankës Kombëtare të Kroacisë (BKK), z. Boris Vujčić, zhvilloi një vizitë zyrtare në Bankën e Shqipërisë. Kjo vizitë shënon një hap të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Kombëtare të Kroacisë. Ajo u çel me takimin dypalësh zhvilluar në ambientet e Bankës së Shqipërisë.



Fillimisht, Guvernatori Sejko falënderoi Guvernatorin Vujčić për vizitën dhe vlerësoi stadin e marrëdhënieve mes dy vendeve dhe

bankave të tyre qendrore, duke shprehur besimin se potenciali për bashkëpunim ekonomik dhe teknik midis tyre mund të zhvillohet më tej. Gjithashtu, ai theksoi se Kroacia mund të shërbejë si udhërrëfyes në procesin e integritit të Shqipërisë në BE.



Gjatë takimit, Guvernatori Sejko bëri një ekspozitë të situatës ekonomike në Shqipëri, ku u shpreh se, pavarësisht situatave sfiduese, ekonomia shqiptare ka vijuar të rritet dhe të shënojë progres në thuajse të gjithë treguesit e stabilitetit ekonomik dhe financiar. Në veçanti, inflacioni tashmë qëndron pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe ka qëndruar në vazhdimësi ndër nivelet më të ulëta të rajonit. Po ashtu, sektori bankar shfaqet me parametra solidë aktiviteti, gëzon bilance të shëndetshme financiare dhe një rezistencë të lartë ndaj goditjeve potenciale, si dhe po furnizon gjithnjë e më shumë me kredi ekonominë shqiptare. Në këtë kontekst, Guvernatori theksoi se Banka e Shqipërisë ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në këtë tablo zhvillimesh, nëpërmjet politikës



së saj të kujdesshme monetare, rregullimit rigoroz dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të sektorit bankar, si dhe nxitjes së zhvillimit të tregjeve financiare dhe të sistemeve të pagesave. Ky investim institucional i ka mundësuar ekonomisë shqiptare një stabilitet të kënaqshëm monetar dhe financiar.



Nga ana e tij, Guvernatori Vujčić vlerësoi se aftësia e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor - dhe veçanërisht e Shqipërisë - në përballimin e krizave ka qenë mbresëlënëse. Ai theksoi se këto zhvillime inkurajuese ofrojnë një platformë solide për rritjen ekonomike dhe procesin e konvergencës me Bashkimin Evropian.

Në kuadër të kësaj vizite zyrtare, u mbajt gjithashtu një tryezë me përfaqësues të sistemit bankar dhe drejtues të lartë të Bankës së Shqipërisë, ku u diskutuan zhvillimet më të fundit ekonomike, inflacioni në rajon dhe BE, euroizimi i ekonomisë dhe sfidat që sjell ai, si dhe çështje të tjera me rëndësi për sistemin bankar si masat mbikëqyrëse dhe rregullatore të vendosura nga Banka Qendrore Evropiane dhe modernizimi i sistemeve të pagesave.

GUVERNATORI SEJKO PRET NË NJË TAKIM ZYRTAR ANËTARIN E BORDIT EKZEKUTIV TË DEUTSCHE BUNDESBANK

11 prill 2024, Tiranë, Shqipëri

Më 11 prill 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, priti në një takim zyrtar një delegacion nga Banka Qendrore e Gjermanisë, të kryesuar nga z. Burkhard Balz, anëtar i Bordit Ekzekutiv të Deutsche Bundesbank, në kuadër të Programit për "Forcimin e kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor me fokus integrimin në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore" dhe bashkëpunimit të deritanishëm të Bankës së Shqipërisë (BSH) dhe Deutsche Bundesbank në lidhje me këtë program.



Guvernatori Sejko falënderoi z. Balz për takimin, duke e vlerësuar maksimalisht



bashkëpunimin e deritanishëm në kuadër të Programit, i cili ka si objektiv forcimin e kapaciteteve të institucioneve përfituese, kryesisht përmes përmirësimit të mëtejshëm të instrumenteve të tyre analitike dhe politike, nëpërmjet përvetësimit të standardeve më të mira ndërkombëtare dhe evropiane në praktikat kombëtare. Ky program mbështetet nga Bashkimi Evropian (BE), nëpërmjet Instrumentit të tij për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA III).

Z. Sejko u shpreh se gjatë fazës së parë të programit u trajnuan rreth 80 punonjës të Bankës së Shqipërisë, ndërkohë gjatë zbatimit të fazës së dytë deri janë trajnuar 24 punonjës, si dhe është vendosur një bashkëpunim dypalësh ndërmjet stafit të Bankës së Shqipërisë dhe Bankës së Spanjës. Ndërkohë, në komponentin e dytë në nivel kombëtar janë parashikuar 6 bashkëpunime dypalëshe dhe 3 internshipe 10-ditore, nga të cilat do të përfitojnë rreth 70 punonjës të BSH-së.



Z. Balz përgëzoi autoritetet për progresin e bërë në aspektin profesional dhe institucional, i cili e ka ndihmuar Shqipërinë në rrugëtimin e zhvillimit ekonomik e social. Gjithashtu, ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të Bundesbank për ta ndihmuar Shqipërinë në procesin e integritimit evropian.

Gjithashtu, gjatë takimit u rikonfirmua rëndësia e bashkëpunimit teknik ndërkombëtar si një instrument për dialog institucional, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i shkëmbimeve të eksperiencave në fusha si mbikëqyrja bankare, sistemet e pagesave, siguria kibernetike etj.

GUVERNATORI SEJKO NË MBLEDHJET E PRANVERËS TË FMN-SË DHE BB-SË 18-21 prill 2024, Uashington, SHBA

Në datat 18-21 prill 2024, u zhvilluan Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), në Uashington. Në këto mbledhje marrin pjesë ministrat e financave të vendeve anëtare, guvernatorë të bankave qendrore, drejtues të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe përfaqësues të botës akademike, biznesit dhe shoqërisë civile.



Shqipëria u përfaqësua në këto takime nga një delegacion i përbashkët i përbërë nga



vijuar edhe në muajt e parë të këtij viti; si edhe me norma të ulëta të papunësisë. Gjithashtu, sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar dhe me norma të larta likuiditeti. Inflacioni ka zbritur në objektivin e Bankës së Shqipërisë brenda një kohe relativisht të shpejtë, duke arritur në 2.3% në muajin mars, kjo edhe si pasojë e ndërhyrjeve dhe politikës monetare



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko; Ministri i Financave, z. Ervin Mete; si dhe drejtues të tjerë të lartë të dy institucioneve.

Gjatë takimeve me përfaqësuesitë lartë të FMN-së dhe BB-së, Guvernatori Sejko dhe Ministri Mete i njohën të pranishmit me zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare, reformat e ndërmarra, si edhe pritshmëritë për periudhën në vazhdim. Ata theksuan se Shqipëria po kalon një momentum të mirë ekonomik. Viti 2023 u mbyll me uljen e mëtejshme të borxhit publik, i cili zbriti në nivelin 59.2%; shifra rekord të investimeve të huaja direkte, të cilat arritën në afro 1.5 miliardë euro; me një numër të lartë vizitorësh të huaj, trend i cili ka



të ndjekur nga BSH-ja, që ka pasur si objektivi amortizimin e goditjeve dhe zbutjen e presioneve të brendshme inflacioniste.



Përfaqësuesit e lartë të FMN-së dhe BB-së e vlerësuan pozitivisht rolin dhe politikën e ndjekur nga autoritetet shqiptare.

Ata veçuan si një zhvillim pozitiv rritjen e vlerësimit për herë të parë të agjencisë Standard&Poor's për kreditin e Shqipërisë, i cili u pasua nga një rishikim në rritje i



perspektivës edhe nga agjencia Moody's, si dhe theksuan se dalja e vendit nga "lista gri" e FATF/MONEYVAL është gjithashtu një lajm me efekte shumë pozitive për Shqipërinë.

GUVERNATORI SEJKO NË AKTIVITETIN E PËRVJETORIT TË 25-TË TË SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE 13 maj 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 13 maj 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, ishte i ftuar në përvjetorin e 25-të të Shoqatës Shqiptare të Bankave. Gjatë fjalës së tij, ai u shpreh se, për gati një çerek shekulli, Shoqata Shqiptare e Bankave ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në zhvillimin e sektorit bankar shqiptar, duke i shërbyer në këtë mënyrë stabilitetit dhe progresit ekonomik e financiar të vendit. Përpjekjet e saj në drejtim të zhvillimit kanë qenë thelbësore, nëpërmjet një angazhimi konkret e proaktiv për adoptimin e praktikave më të mira që ofron industria bankare globale.



Guvernatori theksoi se puna e SHSHB-së për promovimin e praktikave të shëndosha financiare dhe standardeve etike bankare ka formësuar peizazhin e industrisë bankare. Ai shtoi se shërbimet e ofruara u revolucionarizuan, bankat zgjeruan ndjeshëm shtrirjen e tyre, duke ofruar gjithnjë e më shumë produkte e shërbime bankare e financiare, dikur të konsideruara përtej fushës së veprimit të bankingut tradicional. Më tej, Guvernatori nënvizoi se edhe pse ekonomia shqiptare është përballur në vazhdimësi me goditje, sistemi bankar ka kontribuar denjësisht duke

mundësuar një rritje të shpejtë të kredisë për ekonominë, nga niveli 7% i PBB-së në vitin 2002, në nivelin 30% të PBB-së në vitin 2023.



Guvernatori nuk la pa evidentuar faktin se SHSHB-ja, në formën aktuale të saj, i ka ofruar Bankës së Shqipërisë një interlokutor e partner të besueshëm në diskutimin e projekteve e reformave të ndërmarra ndër vite. Ky shkëmbim idesh e pikëpamjesh ka qenë thelbësor për identifikimin e problemeve të zhvillimit dhe për adoptimin e instrumenteve më efektive për adresimin e tyre. Ai theksoi se Qeveria Shqiptare, Banka e Shqipërisë dhe SHSHB-ja kanë kryer një punë të madhe për realizimin e disa reformave të rëndësishme strukturore gjatë dekadës së fundit.

ZËVENDËSGUVERNATORJA E DYTË AHMETAJ NË MINISTERIALIN MIDIS BASHKIMIT EVROPIAN DHE VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR E TURQISË, MOLDAVISË, GJEORGJISË DHE UKRAINËS

14 maj 2024, Bruksel, Belgjikë

Në datën 14 maj 2024, në Bruksel, u zhvillua mbledhja e Ministerialit midis



Bashkimit Evropian (BE) dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor e Turqisë, Moldavisë, Gjeorgjisë dhe Ukrainës, si vende kandidatë për anëtarësim në BE. Qëllimi i kësaj mbledhjeje të përvitshme ishte të miratonte dokumentin e Konkluzioneve të Përbashkëta për programet e reformave ekonomike dhe financiare që këto vende kishin paraqitur në janar 2024. Në mbledhje, Shqipëria u përfaqësua nga Ambasadori i Misionit pranë Bashkimit Evropian, z. Ferit Hoxha, dhe nga Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, znj. Natasha Ahmetaj.

Në fjalën e saj, Zëvendësguvernatorja Ahmetaj u përqendrua tek zhvillimet monetare dhe financiare gjatë vitit 2023. Ajo theksoi veprimet e politikës monetare për kontrollin e inflacionit, të cilat gradualisht u shoqëruan me rënien e tij drejt nivelit objektiv të Bankës së Shqipërisë. Znj. Ahmetaj i cilësoi zhvillimet në sistemin financiar dhe sektorin bankar gjatë



2023 si pozitive, me tregues shumë të mirë të performancës financiare dhe të rezistencës ndaj rreziqeve. Këto të fundit mbeten gjithsesi të pranishme dhe kërkojnë vëmendjen e vazhdueshme të industrisë financiare dhe të autoriteteve rregullatore. Në përfundim, znj. Ahmetaj shprehu dakordësinë e Bankës së Shqipërisë me përmbajtjen e dokumentit.

GUVERNATORI SEJKO TAKON AMBASADOREN E JAPONISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

17 maj 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 17 maj 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, priti në një takim kortezie në Bankën e Shqipërisë, Ambasadore të re të Japonisë në Republikën e Shqipërisë, SH.T.Zj Kikuko Kato. Gjatë këtij takimi, Guvernatori Sejko i shprehu mirënjohjen Ambasadores Kato për marrëdhëniet e mira midis dy vendeve, duke vlerësuar ndihmat e dhëna nga Japonia ndër vite për Shqipërinë, si dhe shprehu besimin se bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Japonisë do të vijojë të thellohet. Ata biseduan rreth perspektivave potenciale të bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve, në fusha si: shkëmbimet tregtare, zhvillimi i teknologjisë së informacionit, infrastruktura etj.



Gjatë bisedës, Guvernatori Sejko e njohu bashkëbiseduesen me panoramën ekonomike në Shqipëri, ku theksoi se pavarësisht situatave sfiduese, ecuria ekonomike në vend paraqitet stabël dhe me tregues mjaft të mirë. Ai theksoi se fokusi i politikave ekonomike gjatë kësaj periudhe ka qenë i orientuar drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, duke përshtatur qëndrimin e politikës monetare, si një parakusht për ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit tonë dhe garantimin e stabilitetit të çmimeve në vend.



Ambasadorja SH.T.Zj Kikuko Kato vlerësoi punën e bërë nga Banka e Shqipërisë në drejtim të përballimit me sukses të sfidave dhe garantimit të stabilitetit financiar në vend. Gjithashtu, ajo u ndal në progresin që Shqipëria ka bërë në kuadër të procesit të integritit evropian.

Bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve midis dy vendeve në funksion të nxitjes së investimeve të huaja në Shqipëri, sidomos në fushën e teknologjisë. Ndaj krijimi i kushteve sa më të mira për investitorët mbetet një synim i rëndësishëm për zhvillimin dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare.

GUVERNATORI SEJKO NË SEANCËN DËGJIMORE TË KOMISIONIT TË EKONOMISË DHE FINANCAVE MBI SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA QË BLEJNË KREDI ME PROBLEME

21 maj 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 21 maj 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, u thirr para deputetëve të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave (KEF) në seancën dëgjimore mbi subjektet financiare jobanka që blejnë kredi me probleme. Në krye të fjalës së tij, Guvernatori theksoi se Banka e Shqipërisë, në përputhje me Nenin 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është përcaktuar si institucion i ngarkuar me dy detyra kryesore: zbatimin e politikës monetare dhe emetimin e monedhës vendase.



Guvernatori u shpreh se Banka e Shqipërisë, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, licencon: “bankat – (11); subjektet financiare jobanka – (26); shoqëritë e kursim-kreditit – (16)”, për të ushtruar aktivitetin kreditues. Ai u shpreh se këto subjekte financiare (banka dhe jobanka) e kanë mbështetur në vazhdimësi ekonominë e vendit nëpërmjet aktivitetit të kredidhënies dhe sot i gjithë portofoli i kredisë vlerësohet në nivelin 805 miliardë lekë.



Më tej, Guvernatori bëri një ekspoze të historikut të subjekteve financiare jobanka që kanë si aktivitet kryesor kreditimin, nëpërmjet të cilit i vijnë në ndihmë një kategorie të caktuar konsumatorësh dhe bizneseve të vogla që nuk arrijnë të kenë qasje në sistemin bankar. Ai shtoi se praktika e shitblerjes së kredive me probleme u shfaq në tregun financiar shqiptar pas krizës financiare globale të viteve 2008-2010. Në këtë kontekst, Qeveria Shqiptare dhe Banka e Shqipërisë, në shtator 2015, miratuan “Planin kombëtar për reduktimin e kredive me probleme”. Përveç të tjerash, Plani i ngarkonte Bankës së Shqipërisë detyrën e rregullimit dhe licencimit të shoqërive që angazhoheshin në blerjen e kredive me probleme, praktikë kjo e njohur ndërkombëtarisht dhe e rekomanduar fort nga ekspertët e FMN-së dhe Bankës Botërore. Në atë periudhë, disa institucione financiare, krahas aktivitetit kredidhënës për të cilin ishin licencuar nga Banka e Shqipërisë, kishin kryer edhe blerje të portofoleve të kredive me probleme nga bankat, aktivitet ky i mbështetur



në dispozitat e Kodit Civil për kalimin e kredive (përkatësisht nenet 499 – 507 dhe 705). Aktualisht janë 5 subjekte që krahas aktivitetit kredidhënës, kryejnë edhe aktivitetin e blerjes së portofoleve të kredive me probleme.

Guvernatori theksoi se marrëdhëniet e mëtejshme tregtare midis bankave dhe këtyre institucioneve, në lidhje me shitblerjen e portofolit të kredive me probleme, nuk janë kompetencë e Bankës së Shqipërisë. Ato rregullohen përmes kontratave të lidhura midis palëve sipas Kodit Civil.

Në përfundim të fjalës së tij, Guvernatori theksoi se Banka e Shqipërisë ka vepruar, në çdo kohë, në përputhje të plotë me detyrimet që i njej ligji dhe mbetet gjithmonë e gatshme të bëjë transparencë të plotë përpara publikut, institucioneve shtetërore dhe mediave, në lidhje me veprimtarinë e saj rregulluese dhe mbikëqyrëse.

GUVERNATORI SEJKO PREZANTON RAPORTIN VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2023 NË KOMISIONIN E EKONOMISË DHE FINANCAVE

28 maj 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 28 maj 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, prezantoi përpara deputetëve të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave (KEF) Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023.

Gjatë fjalës së tij, Guvernatori Sejko theksoi se aktiviteti i Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2023 është orientuar në tre shtylla kryesore.



Së pari, Banka e Shqipërisë është kujdesur për forcimin e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit, si një parakusht i rëndësishëm për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit dhe përmirësimin e mirëqenies shoqërore. Së dyti, janë përmbushur të gjitha angazhimet institucionale, duke synuar që Banka të jetë jo vetëm një promotor zhvillimi i industrisë financiare, por edhe një partner i besueshëm i publikut shqiptar. Së treti, dhe po aq e rëndësishme, Banka i ka kushtuar vëmendje respektimit të të gjitha rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023.

Ai theksoi se viti 2023 ishte një vit progresi për ekonominë shqiptare. Më konkretisht, Guvernatori evidentoi disa nga drejtimet dhe rezultatet kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2023:

- Viti 2023 u karakterizua nga një rritje solide e aktivitetit ekonomik, e punësimit dhe e pagave, si dhe nga përmirësimi i treguesve kryesorë të stabilitetit ekonomik e financiar të vendit. Sipas të dhënave të INSTAT-it, vëllimi i aktivitetit ekonomik në vend u rrit me 3.4% gjatë vitit të shkuar, duke regjistruar një përmirësim gradual të ritmeve të rritjes gjatë tremujorëve. Paralelisht me të, punësimi u rrit me 2.2%, ndërsa norma e papunësisë zbriti në minimumin e ri historik prej 10.7% në fund të vitit.
- Viti 2023 shënoi përmirësime edhe në ekuilibrat e brendshëm e të jashtëm të ekonomisë.
- Inflacioni shënoi një rënie graduale, por të

vazhdueshme gjatë vitit 2023. Ai zbriti nga niveli 7.4% në fillim të vitit 2023, në nivelin 4% në fund të tij, dhe në nivelin 2.7% në tremujorin e parë të vitit 2024. Kjo ecuri u ndikua nga rënia e inflacionit në tregjet e huaja, nga mbiçmimi i kursit të këmbimit dhe nga normalizimi i qëndrimit të politikës sonë monetare.

- Ritmi i normalizimit të politikës monetare ishte më i ngadaltë se ai i vitit paraardhës. Ky ngadalësim pasqyroi forcimin e kursit të këmbimit dhe kahun konsolidues të politikës fiskale. Mbiçmimi i shpejtë i Lekut ndihmoi në zbutjen e presioneve të huaja inflacioniste, ndërsa konsolidimi fiskal ndihmoi në frenimin e presioneve të brendshme.
- Transmetimi i vendimeve të politikës monetare në tregjet financiare ishte i kënaqshëm. Rritja e normës bazë solli një rritje të përgjithshme të nivelit të normave të interesit, ndonëse kushtet e përgjithshme të financimit në vend mbeten ende stimuluese.
- Normalizimi i qëndrimit të politikës monetare mundësoi reduktimin e inflacionit, pa dëmtuar trendin pozitiv të rritjes ekonomike.
- Sektori bankar shqiptar e mbylli vitin 2023 me një rezultat financiar pozitiv, me një nivel të lartë të treguesve të likuiditetit e të kapitalizimit të veprimtarisë, si dhe me një përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së kredisë. Analizat tona periodike tregojnë se rreziqet sistemike të sistemit bankar mbeten të kontrolluara.
- Edhe gjatë vitit 2023, ne kemi vijuar punën për mbikëqyrjen dhe rregullimin e kujdesshëm të sektorit bankar, për zhvillimin e tregjeve financiare dhe të sistemeve të pagesave, si dhe për forcimin e rrjetave të sigurisë në sistem.
- Banka e Shqipërisë siguroi funksionimin normal të sistemeve të pagesave, nëpërmjet operimit dhe administrimit të 3 infrastrukturave kryesore për procesimin e pagesave ndërbankare dhe 1 infrastrukturë për shlyerjen e titujve. Të gjitha sistemet kanë ofruar disponueshmëri maksimale.

Sistemi më i ri i shlyerjes të pagesave në Euro brenda vendit përjetoi një rritje të mëtejshme të përdorimit gjatë vitit 2023. Për rrjedhojë, vetëm gjatë vitit 2023, përdorimi i këtij sistemi vlerësohet t'i ketë kursyer i konsumatorëve dhe bizneseve shqiptare rreth 37 milionë euro.

- Paralelisht me nxitjen dhe sigurimin e mbarëvajtjes së pagesave elektronike, ne kemi akomoduar edhe kërkesën e ekonomisë për para fizike. Pas përfundimit të emetimit të serisë së re të kartëmonedhave në vitin 2022, gjatë vitit 2023 ne kemi plotësuar të gjitha kërkesat e ekonomisë shqiptare për para fizike, si në vlerë edhe në strukturë.



Banka e Shqipërisë ka përmbushur detyrimet institucionale që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Raportet e Progresit të Komisionit Evropian, nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, si dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian. Me hapjen e negociatave, ajo ka kontribuar aktivisht në takimet bilaterale *screening* për çdo kapitull të *Acquis*-it midis delegacioneve shqiptare dhe përfaqësuesve të Komisionit Evropian. Gjithashtu, ka vazhduar të drejtojë hartimin e kapitujve 4 dhe 17, përkatësisht për "Lëvizjen e lirë të kapitalit" dhe "Politikën ekonomike dhe monetare".

Në përfundim të fjalës së tij, Guvernatori theksoi edhe një herë angazhimin dhe përkushtimin e Bankës së Shqipërisë për respektimin e të gjitha detyrave ligjore dhe

angazhimeve institucionale. Ky angazhim dokumentohet edhe në Strategjinë Afatmesme të Bankës së Shqipërisë, një përmbledhje e së cilës është pjesë integrale e Raportit.

GUVERNATORI SEJKO NË NJË TAKIM ME PRESIDENTIN E MASTERCARD EUROPE **12 qershor 2024, Tiranë, Shqipëri**

Në datën 12 qershor 2024, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, zhvilloi një takim zyrtar me z. Mark Barnett, President i Mastercard Europe, si dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kompanisë. Pas një diskutimi të përgjithshëm mbi zhvillimet ekonomike dhe të tregut bankar e financiar të vendit, biseda mes palëve u thellua në promovimin e pagesave elektronike në ekonominë shqiptare dhe mundësitë e bashkëpunimit në të ardhshmen.



Fillimisht, Guvernatori Sejko prezantoi masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për nxitjen e përfshirjes financiare dhe të përdorimit të pagesave elektronike, të cilat janë reflektuar më së miri në ekonominë shqiptare, duke arritur dhe tejkuluar objektivat fillestarë të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël.

Në këtë drejtim, z. Barnett konfirmoi se, bazuar në transaksionet e procesuara

nga Mastercard, vendi ynë ka një shtim të qenësishëm të pagesave me kartë në vitet e fundit. Po ashtu, nga të dhënat në dispozicion, rezultojnë se Shqipëria është vendi i dytë në Evropë dhe i tretë në botë me rritjen më të lartë të turizmit në vitin që lamë pas.



Në vijim, Guvernatori Sejko dhe z. Barnett shqyrtuan vijimin e mëtejshëm të politikave stimuluese për përdorimin sa më të gjerë të pagesave elektronike edhe në transaksionet e përditshme të qytetarëve. Në këtë kuadër, u diskutua mundësia e prezantimit të aplikacioneve të pagesave me kartë nëpërmjet celularit, e cila do të nxiste përfshirjen financiare të popullsisë shqiptare. Palët theksuan nevojën për reduktim të kostove të transaksioneve me karta, si një prej rekomandimeve të Bashkimit Evropian, si dhe ranë dakord të bashkëpunojnë për të promovuar këto mënyra inovative që mundësojnë ofrimin e shërbimeve efikase, si nga pikëpamja e lehtësisë së përdorimit ashtu edhe nga ajo e uljes së kostove.

GUVERNATORI SEJKO NË EVENTIN PROMOVUES TË APLIKACIONIT TEA 2.0 **12 qershor 2024, Tiranë, Shqipëri**

Në datën 12 qershor 2024, në ambientet e selisë qendrore nr.2 të Bankës së Shqipërisë,

u prezantua Kalendar i Digjital i Eventeve në Turizëm përmes aplikacionit TEA 2.0, një aktivitet i zhvilluar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit.



Në fjalën e tij përshëndetëse, Guvernatori Sejko i uroi të pranishmëve mirëseardhjen në ambientet e reja të Bankës së Shqipërisë - dikur të njohura si Hotel "Dajti" - duke u shprehur se ky monument kulture, i cili i është rikthyer tashmë thesarit të trashëgimisë sonë kulturore, u rindërtua me një vizion të qartë,



atë të ruajtjes së vlerave dhe stilit arkitekturor të kohës. Ai theksoi se projekti i rijetësimit ishte sa impenjativ aq dhe shpërblyes. E kthyer tashmë në një ndërtesë shumëfunktionale, kjo godinë nuk do të shërbejë thjesht si një "shtëpi" për Bankën e Shqipërisë, por do të jetë në dispozicion të institucioneve dhe publikut, si një vendtakim për aktivitete informuese dhe edukuese, me ambiente të dedikuara.



Me këtë rast, godina hapi dyert për të mirëpritur një aktivitet kushtuar një motori të fuqishëm të vendit tonë, turizmit, i cili po e ndikon gjithnjë e më shumë ekonominë e tij. Guvernatori u shpreh se zhvillimi i vullshëm i këtij sektori ka sjellë një përmirësim cilësor të bilancit të shkëmbimeve tregtare me jashtë, duke u pasqyruar në përmirësimin e renditjes së rrezikut të borxhit sovran nga agjencitë e huaja gjatë vitit 2023, nga niveli B+ në nivelin BB- sipas Standard & Poor's. Ai shtoi se Shqipëria po përjeton një interes në rritje për investime në sektorin e banesave rezidenciale gjatë viteve të fundit, kryesisht në zonat bregdetare. Vetëm për vitin 2023, ky investim arriti në nivelin e 350 milionë eurove.

Guvernatori theksoi se të gjitha këto kanë kontribuar direkt në rritjen me 3.44% të ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2023, në rënien e papunësisë në nivelet minimale historike, prej 10.7%, si dhe në rritjen me 14% të pagave në sektorin privat. Paralelisht me të, gjatë vitit të shkuar, Shqipëria shënoi dhe një rekord historik të investimeve të huaja direkte, në nivelin 1.5 miliardë euro, dhe një rritje me

11.3% të remitancave, duke arritur në nivelin 930 milionë euro. Ai shtoi se banka qendrore është kujdesur në vazhdimësi të ndjekë politika të kalibruara, në ruajtje të stabilitetit të çmimeve dhe atij financiar, dëshmi e të cilave është niveli i sotëm i inflacionit prej 2.2% në muajin maj 2024.

BANKA E SHQIPËRISË DHE BANKA BOTËRORE ORGANIZOJNË WORKSHOP-IN "RRUGËTIMI I SHQIPËRISË DREJT INTEGRIMIT NË SEPA, PËRFSHIRJES DHE EDUKIMIT FINANCIAR"

14 qershor 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 14 qershor 2024, Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore zhvilluan Workshop-in me temë "Rrugëtimi i Shqipërisë drejt integrimit në SEPA, përfshirjes dhe edukimit financiar". Qëllimi i këtij aktiviteti ishte diskutimi i statusit të integrimit të Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA) dhe i përfitimeve për vendin, si dhe i rëndësisë së përfshirjes dhe edukimit financiar për zhvillimin e tregut dhe mirëqenien shoqërore.



Gjatë fjalës së tij, Guvernatori Sejko u shpreh se sot më shumë se kurrë rritja dhe stabiliteti

ekonomik varen nga fuqizimi financiar i të gjithë qytetarëve. Si rrjedhojë e zhvillimeve të shpejta në fushën e financës, inteligjencës artificiale, digjitalizimit të ekonomisë dhe parasë, angazhimi ynë ndaj këtyre objektivave është kthyer në një domosdoshmëri.



Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar ndjeshëm përpjekjet për anëtarësimin e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro – SEPA falë të cilave, dy ditë më parë, u arrit të përmbylej me sukses faza e aplikimit pranë Këshillit Evropian të Pagesave. "Thjeshtësia, komoditeti dhe efikasiteti janë tre nga përfitimet kryesore të këtij anëtarësimi për konsumatorët dhe bizneset. Përmes SEPA-s, qytetarët dhe bizneset shqiptare do të kryejnë pagesa dhe transfertat sikur të ishin qytetarë të Bashkimit Evropian dhe anasjelltas. Përfitimet kryesore të ekonomisë shqiptare dhe familjeve do të jenë të konsiderueshme në fushat e tregtisë, turizmit, remitancave, investimeve direkte etj." - tha Guvernatori.



Në këtë drejtim, Guvernatori përgëzoi ekipin e Bankës së Shqipërisë përgjegjës për këtë projekt, atë të Bankës Botërore, Qeverisë dhe të gjitha autoritetet e tjera kombëtare që kanë mbështetur aspiratën e Bankës së Shqipërisë për anëtarësimin e përsheptuar në SEPA.

ZËVENDËSGUVERNATORJA MINXHOZI NË SAMITIN ME TEMË "STABILITETI FINANCIAR DHE MONETAR I RAJONIT NË KUSHTET E RITJES SË ULËT EKONOMIKE TË EUROZONËS"

14-15 qershor 2024, Becic, Mali i Zi

Në datat 14-15 qershor 2024, Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, ndoqi punimet e samitit vjetor të vendeve të rajonit, të mbajtur në Becic, Mal i Zi. Samiti i këtij viti, me temë "Stabiliteti financiar dhe monetar i rajonit, në kushtet e rritjes së ulët ekonomike të Eurozonës", trajtoi zhvillimet më të fundit në ekonomitë e rajonit. Ai ishte i organizuar në katër panele kryesore, me temat: reforma dhe modernizimi i administratës tatimore – qëllimet, arritja dhe sfidat; vlerësimi i



menaxhimit të investimeve publike; ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe sistemit bankar në kohë pasigurie; politika fiskale si parakusht për rritjen e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit ekonomik, në kushtet e rritjes së ulët në Eurozonë.



Paneli i guvernatorëve – pjesë e të cilit ishte edhe Zëvendësguvernatorja Minxhozi - trajtoi temën "Ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe sistemit bankar në kohë pasigurie". Në krye të fjalës së saj, zj. Minxhozi vlerësoi rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete të tilla, si një mundësi për të ndarë pikëpamje e përvoja mes bankave qendrore të vendeve të rajonit, si dhe për të shkëmbyer mendime mbi zgjidhjen e problematikave të momentit.

ZËVENDËSGUVERNATORJA AHMETAJ PËRSHËNDET CEREMONINË E DIPLOMIMIT TË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT "EPOKA"

27 qershor 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 27 qershor 2024, Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të studentëve të Universitetit "Epoka", për vitin akademik 2023-2024. Gjatë kësaj ceremonie,

Zëvendësgovernatorja Ahmetaj mbajti një fjalë për të pranishmit, ku fillimisht i përgëzoi studentët për diplomimin dhe u uroi atyre suksese në rrugën e karrierës.



Zëvendësgovernatorja u shpreh se pa entuziazmin e të rinjve që i bën vështirësitë të duken më të kapërcyeshme, pa talentin e tyre që e sfidon pedagogun drejt niveleve më të larta të shkencës moderne, ne nuk do të mund ta projektonim Evropën si destinacion të ekonomistëve, financierëve dhe menaxherëve të rinj. Ajo shtoi se binomi "staf akademik cilësor-student i angazhuar për dije" është baza e së ardhmes së një vendi. Ky binom i shpërthen kufijtë e një shkolle lokale drejt dimensioneve ndërkombëtare, gjë që ka ndodhur e po ndodh në një perimetër që zgjerohet çdo ditë me institucione si Universiteti "Epoka".

Zëvendësgovernatorja theksoi se Ekonomia e Dijes ka sjellë një ndryshim të mrekullueshëm në ndarjen botërore të punës, duke krijuar struktura në të gjitha ekonomitë e globit, pavarësisht nivelit të zhvillimit e distancës, si dhe duke shkëmbyer burime njerëzore, procese, ide e teknologji. Ajo shtoi se e vetmja mënyrë për të përfituar prej saj është përfshirja në zinxhirin global të prodhimit dhe aftësimi për të menaxhuar informacion kompleks.

AKTIVITETET E BANKËS SË SHQIPËRISË

KREMTOHET JAVA E PARASË 18 mars 2024, Tiranë, Shqipëri

Në datën 18 mars 2024, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u çel Java Globale e Parasë për vitin 2024, gjatë së cilës do të organizohen aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuere dhe edukative. Kjo Javë është një festë mbarëbotërore e parasë, e cila synon ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të rinjve për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirëmenduara.

Aktivitetin çelës të Javës së Parasë 2024 e përshëndetën z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, zj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Arsimit dhe Sportit, dhe z. Bledar Shella, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Guvernatori Sejko prezantoi temën e këtij viti "Mburo paratë e tua, siguro të ardhmen tënde!", e cila thekson nevojën për të përqaftuar një qasje të përgjegjshme dhe të informuar në administrimin e financave personale, duke u bërë të vetëdijshëm për rreziqet potenciale në ndërveprimin financiar.

Guvernatori u shpreh se është shumë e rëndësishme për të rinjtë të identifikojnë rreziqet e lidhura me mashtrimet online, si dhe rreziqet e tjera që rrjedhin nga informacionet dhe këshillat e pasigurta. Ai theksoi se gjatë kësaj jave, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me partnerët e saj, do të organizojnë aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuere për nxënësi të arsimit parauniversitar dhe studentë.

Më tej, Guvernatori theksoi se Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë dhe po zbaton

dy strategji të rëndësishme për klimën dhe edukimin e përfshirjen financiare. Strategjia e edukimit shërben si instrument për institucionet arsimore, bankare, financiare, bizneset, OJQ-të etj. që të zhvillojmë së bashku politika, programe dhe materiale edukative, me qëllimin kryesor përmirësimin e kulturës financiare në të gjithë vendin. Përparimi në këtë nismë na përball me sfida dhe rëndësia e ndarjes së përvojave, e mësimit nga njëri-tjetri për të rritur dhe promovuar kulturën financiare bëhet gjithnjë e më e nevojshme.

Më tej, aktiviteti vijoi me ceremoninë e ndarjes së çmimeve për fituesit e 5 konkurseve të para të organizuara nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave me rastin e këtij kremtimi.

LEKSIONE NË UNIVERSITETE NË KUADËR TË JAVËS SË PARASË

Në kuadër të Javës së Parasë, Zëvendësguvernatorja e Parë, zj. Minxhozi, si dhe Zëvendësguvernatorja e Dytë, zj. Ahmetaj, zhvilluan disa leksione të hapura për studentët me ftesë nga disa universitete brenda vendit.



Më konkretisht, më 19 mars 2024, me ftesë të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Fakulteti



i Biznesit, Durrës, Zëvendësguvernatorja e Dytë, zj. Ahmetaj, mbajti një leksion të hapur për "Financat në Ekonominë e Dijes", si një reflektim mbi fazën e re ku ka hyrë sistemi ekonomik botëror dhe përshtatjen e sektorit financiar me këtë zhvillim. Gjatë leksionit, Zëvendësguvernatorja theksoi rolin thelbësor të inovacionit, zhvillimit të arsimit dhe mbështetjes nga institucionet financiare, si një infrastrukturë ndërmjetësuese për përfshirjen e një vendi në Ekonominë e Dijes.





vendit, duke kontribuar në rritjen e përfshirjes financiare dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

Më 25 mars 2024, Zëvendësguvernatorja Minxhozi mbajti leksionin me temë "Edukimi Financiar, çelësi për të maksimizuar përfitimet nga inovacionet në sistemin e pagesave", në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Gjatë këtij leksioni, Prof. Dr. Minxhozi diskutoi me studentët hapat e rëndësishëm që banka qendrore po ndërmerr për të modernizuar sistemin financiar në Shqipëri, përmes zbatimit të ligjit "Për Shërbimet në Pagesa". Ajo u shpreh se ky ligj, në fuqi prej vitit 2020, synon ndër të tjera të nxisë formalizimin, konkurrencën dhe eficiencën në sektorin financiar, duke i ofruar qytetarëve dhe bizneseve mundësinë të përdorin instrumente inovative të pagesave që i kthejnë telefonat e tyre në portofola digjitalë. Ky ligj u mundëson qytetarëve të kryejnë transaksione financiare me kosto pothuajse zero, në kohë të shkurtër, dhe është veçanërisht i rëndësishëm për të rinjtë,



Më 19 mars, me ftesë të Dekanes së Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Zëvendësguvernatorja Minxhozi mbajti leksionin me temë "Zhvillimet e tregut financiar dhe sfidat e edukimit financiar në këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë". Ajo theksoi jo vetëm rëndësinë e përfshirjes dhe edukimit financiar, por edhe sfidat dhe rreziqet që vijnë së bashku me inovacionet financiare. Prof. Dr. Minxhozi u ndal edhe në rolin e Bankës së Shqipërisë për përmirësimin dhe modernizimin e sistemit të pagesave të



të cilët pritet të jenë përdoruesit kryesorë dhe përfituesit më të mëdhenj të inovacioneve që mundëson ligji.

Më 29 mars 2024, Zëvendësguvernatorja e Dytë, zj. Ahmetaj, mbajti leksionin me temë "Integrimi ekonomik: dije dhe financim", me ftesë të Dekanit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali". Leksioni u përqendrua në nevojën për të kuptuar oportunitetet që sjell ekonomia e dijes për vendet në zhvillim, si dhe orientimi drejt dijes dhe inovacionit si mënyra e vetme për të përfituar prej tyre. Duke u ndalur në ndryshimet që përhapja e ekonomisë së dijes po sjell në ndarjen ndërkombëtare të punës, Zëvendësguvernatorja identifikoi arsimin dhe sektorin financiar si aleatët kryesorë të këtij progresi. Në këtë kontekst, Ahmetaj shprehu vlerësimin për brezat e studentëve dhe profesorëve që vijojnë të kontribuojnë në emrin e mirë të këtij universiteti.

GUVERNATORI SEJKO NË AKTIVITETIN E ORGANIZUAR NGA MINISTRJA E SHETIT PËR RININË DHE FËMIJËT, ZJ. BORA MUZHAQI, NË KUADËR TË JAVËS GLOBALE TË PARASË 2024

12 prill 2024, Tiranë, Shqipëri

Më datë 12 prill, Guvernatori Sejko, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga zj. Bora Muzhaqi, Ministre e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në kuadër të Javës Globale të Parasë, për të diskutuar në panelin me temë "Si t'i mbrojmë paratë e njerëzve dhe të ardhmen e tyre financiare", së bashku me z. Ervin Mete, Ministër i Financave, dhe z. Eduard Shalsi, Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.



Gjatë panelit, Guvernatori Sejko u shpreh se të gjitha bankat qendrore moderne i kushtojnë vëmendje dhe burime të veçanta edukimit financiar dhe ekonomik të publikut. Kjo dukuri është intensifikuar dhe ka marrë një formë të plotë në mënyrë të veçantë në periudhën e paskrizës financiare, kryesisht për arsye se autoritetet financiare kuptuan rëndësinë e operimit në një ambient me publik të mirinformuar.



Ai u shpreh se prej afro 20 vjetësh, Banka e Shqipërisë është angazhuar në zgjerimin dhe

thellimin e kulturës financiare të publikut në vend, e veçanërisht të brezit të ri. Më tej, ai shtoi se në janar 2024, u miratua Strategjia e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare - një dokument i parë institucional që promovon edukimin financiar, në nxitje të përfshirjes, mirëqenies dhe qëndrueshmërisë financiare. Misioni i tij është të sigurojë që individët në Shqipëri të fitojnë njohuritë, të zotërojnë aftësitë, të mbajnë qëndrimet dhe të zhvillojnë sjelljet e duhura, të sakta dhe të zbatueshme që u mundësojnë atyre të marrin vendime financiare të mirinformuara, me synim final përmirësimin e mirëqenies dhe qëndrueshmërisë së tyre financiare.

Së fundmi, Guvernatori theksoi se aktivitetet dhe botimet e veçanta edukative të përgatitura nga Banka e Shqipërisë në këtë drejtim kanë tre objektiva kryesorë: prezantimin e rolit dhe funksioneve të bankës qendrore tek publiku; kultivimin e përforsimit të një kulture financiare në shoqërinë shqiptare; si dhe nxitjen e përfshirjes financiare.

EKSPOZITË “BERATI NË SHEK. XVIII-XX: ZHVILLIMI EKONOMIK DHE TREGTAR, KOLEKSIONE TË KARTËMONEDHAVE LOKALE TË QYTETIT, OBJEKTE ME RËNDËSI HISTORIKE TË BERATIT TË PASQYRUARA NË MONEDHËN KOMBËTARE”

18 - 19 prill 2024, Berat, Shqipëri

Më 18 dhe 19 prill 2024, Muzeu i Bankës së Shqipërisë dhe Qendra Kombëtare e

Muzeve, Berat, organizuan ekspozitën e përbashkët fotografike “Berati në shek. XVIII-XX: Zhvillimi ekonomik dhe tregtar, koleksione të kartëmonedhave lokale të qytetit, objekte me rëndësi historike të qytetit të pasqyruara në monedhën kombëtare”, në ambientet e Muzeut Ikonografik “Onufri”, në Berat.



Në ceremoninë e hapjes së ekspozitës, z. Altin Tanku, Drejtor i Departamentit të Kërkimeve pranë Bankës së Shqipërisë, së bashku me drejtorin e Qendrës Muzeore Berat, z. Miklor Pasku, përshëndetën të pranishmit. Z. Tanku shpjegoi se si kjo ekspozitë nxjerr në pah rolin e rëndësishëm të Beratit, si një qendër e ekonomisë në nivel kombëtar. Në vlerësim të rolit të tij në ekonomi, histori e trashëgimi kulturore, Berati është përzgjedhur për të qenë pjesë e simbolikës së monedhës tonë kombëtare të qarkullimit, por edhe të asaj numizmatike. Një vëmendje të veçantë ekspozita i kushtoi Kodikut të Purpurt të Beratit, si dokumenti historik më i vjetër që ruhet sot në Shqipëri. Qoftë i parë si objekt kulture, qoftë si trashëgimi e gjallë e kultivimit të krishtërimit në vendin tonë, ky kodik përmban vlera të përveçme që jo vetëm lidhin të tashmen me të shkuarën, por që përbëjnë edhe vetë fillin e vazhdimësisë kulturore të shqiptarëve ndër shekuj.

Në vitin 2005, Kodiku i Purpurt i Beratit nr. 1 u bë pjesë e regjistrimit “Kujtesa e Botës” të UNESCO-s. Këtë objekt të vyer të trashëgimisë sonë, Banka e Shqipërisë e nderoi në vitin 2011 përmes monedhës numizmatike

përkujtimore 50 Lekë "Kodiku i Purpurt i Beratit 043 Φ – Beratinus 1".



Ekspozita u vizitua edhe nga zj. Bora Muzhaqi, Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët, e cila, duke u ndalur në këndin edukativ të ekspozitës, theksoi rëndësinë e rolit të Bankës Qendrore dhe institucioneve shtetërore për edukimin financiar të brezit të ri, si dhe inkurajoi nxënësit që të mësojnë mbi financat, duke e bërë kulturën financiare pjesë të formimit të tyre të përgjithshëm. Ajo u shpreh se bashkërendimi i përpjekjeve ndërinstucionale në këtë fushë është



domosdoshmëri për rritjen e kulturës financiare në vend.

BANKA E SHQIPËRISË ORGANIZON DITËN NDËRKOMBËTARE TË MUZEVE

18 maj 2024, Tiranë, Shqipëri

Që prej vitit 1977, çdo 18 maj, në të gjithë botën festohet Dita Ndërkombëtare e Muzeve. Kjo datë e vendosur nga Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve – ICOM i UNESCO-s - synon të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi rolin e muzeve në zhvillimin e shoqërisë. Në këtë kuadër, edhe këtë vit, më 17 maj 2024, Muzeu i Bankës së Shqipërisë organizoi veprimtari të ndryshme për publikun e gjerë, si dhe qëndroi i hapur për vizitorët përtej orarit të tij zyrtar.





Gjatë kësaj dite, nën sloganin “Muzetë për edukim dhe kërkim/Museums for education and research”, Muzeu i Bankës së Shqipërisë mirëpriti rreth 750 vizitorë. Ata u njohën me koleksionin e pasur numizmatik të Bankës së Shqipërisë, historikun ekonomik e monetar vendas, si dhe me aktivitetet e veçanta dedikuar kësaj dite në përputhje me temën ndërkombëtare.



EKSPOZITA “MONEY SMART – EDUKIM FINANCIAR PËR TË GJITHË”

13-28 qershor 2024, Tiranë, Shqipëri

Më 13 qershor 2024, Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore, me mbështetjen financiare të SECO, çelën Ekspozitën edukative “MONEY smART – Edukim financiar për të gjithë”. Ekspozita qëndroi e hapur në datat 13-28 qershor 2024, në lulishten përpara selisë qendrore nr. 2 të Bankës së Shqipërisë.



Ekspozita “MONEY smART – Edukim financiar për të gjithë” është fryti i parë i Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare, miratuar në fillim të vitit 2024, si dëshmi e angazhimit serioz të Bankës së Shqipërisë në këtë fushë.

Ceremonia çelëse e kësaj ekspozite mbledhi fëmijë të grup-moshave të ndryshme, të cilët mësuan, por edhe u argëtuan në këndet e artit,





ku mësues arti i ndihmuan të krijojnë piktura apo skulptura, duke përdorur kartëmonedhat e grira të Bankës së Shqipërisë; u bënë pjesë e kuizit interaktiv; bënë fotografi në kornizën tonë të fotografimit me një hashtag tërheqës, të lidhur me edukimin financiar për të inkurajuar shpërndarjen në media sociale dhe angazhimin virtual të aktivitetit; morën "Fortune Cookies" me thënie të shkurtra të personaliteteve botërore mbi paranë apo financat etj.



Të pranishmit u përshëndetën nga Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, dhe nga kryespecialistja e sektorit financiar në Grupin e Bankës Botërore, zj. Oya Ardic. Zëvendësguvernatorja Minxhozi u shpreh se bota e financave ka qenë gjithmonë një fushë e vështirë për t'u kuptuar nga publiku i gjerë, por rritja e produkteve dhe shërbimeve që ofron tregu e kanë kthyer në domosdoshmëri zotërimin e një niveli minimal kulture financiare për një vendimmarrje të informuar e që përfiton nga mundësitë e ofruara e që shmang rreziqet. E ndërgjegjshme për këtë, Banka e Shqipërisë prej vitesh investon në krijimin e një kulture financiare në shoqërinë shqiptare.

Ndërkohë, zj. Ardic e vlerësoi edukimin financiar si gur themeli të një ekonomie të lulëzuar, duke fuqizuar individët të lundrojnë në një peizazh financiar kompleks e në zhvillim të shpejtë dhe për të shfrytëzuar shërbimet financiare për një mirëqenie afatgjatë.

TË TJERA

HIDHEN NË QARKULLIM MONEDHAT METALIKE SHQIPTARE ME KURS LIGJOR, ME VLERË NOMINALE 10 LEKË DHE 5 LEKË, EMETIME TË VITIT 2023

Më 28 maj 2024 dhe 20 qershor 2024 u hodhën në qarkullim monedhat metalike shqiptare me vlerë nominale 10 Lekë dhe 5 Lekë, me kurs ligjor, emetime të vitit 2023.

Rishtypja e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me vlerë nominale 10 Lekë



dhe 5 Lekë, u miratua me vendimin nr. 2, datë 18.1.2023, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Këto monedha kanë të njëjtën përbërje, pamje, përmasa dhe peshë me emetimin e fundit të kësaj prerjeje, por mbajnë të shtypur si vit emetimi vitin 2023.

BANKA E SHQIPËRISË BËHET PJESË E RRJETIT PËR QËNDRUESHMËRINË E BANKAVE DHE FINANCAVE (SBFN)

Rrjeti për Qëndrueshmërinë e Bankave dhe Financave (ose SBFN) mirëpret Bankën e Shqipërisë si anëtarin më të ri. Banka e Shqipërisë ka treguar një përkushtim serioz dhe ka bërë përparime të matshme në ngritjen e një mjedisi të favorshëm për financat e qëndrueshme. Një ndër to është hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Gjellbër Afatmesme 2023-2025: "Strategjia për Administrimin dhe Mbikëqyrjen e Rreziqeve Financiare të lidhura me Klimën në Sektorin Financiar 2023-2025", e cila përcakton një plan veprimi

gjithëpërfshirës për ngritjen e kapaciteteve; punën kërkimore; vlerësimin e rrezikut; dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe kombëtar në fushën e zhvillimit dhe arritjes së financave të qëndrueshme.

GUVERNATORI SEJKO INTERVISTË PËR REVISTËN MONITOR

Në një intervistë ekskluzive për Revistën MONITOR, Guvernatori Sejko foli në lidhje me ecurinë e kursit të këmbimit, arsyet dhe pasojat ekonomike të saj. Artikulli i revistës shpreh këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë mbi këto çështje. Më konkretisht:

- Mbi arsyet e forcimit të kursit të këmbimit të Lekut

Në një regjim të lirë të kursit të këmbimit, sikundër aplikohet në Shqipëri, dinamika e kursit është funksion i raportit të kërkesës dhe ofertës për valutë. Në mungesë të ndërhyrjeve të autoriteteve publike, ky raport diktohet nga forcat e tregut dhe i përgjigjet trendeve ekonomike e financiare të vendit. I parë në këtë kontekst, forcimi i kursit të këmbimit të Lekut gjatë vitit 2023 sugjeron praninë e një teprice oferte valute në tregun e brendshëm valutë. Analiza e informacionit të disponuar tregon se kjo tepricë është diktuar nga përmirësimi i fortë dhe i vazhdueshëm i bilancit të shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë gjatë dy viteve të fundit.

- Mbi pasojat ekonomike dhe reagimin e Bankës së Shqipërisë ndaj forcimit të kursit të këmbimit gjatë vitit 2023

Në harkun kohor të dy viteve, kursi i këmbimit të Lekut ndaj Euros është forcuar me 10.2% në terma (T1-T3 2023 kundrejt T1-T3 2021),

ndërsa vëllimi i eksporteve totale shqiptare është rritur me 80% për të njëjtën periudhë. Në këto rrethana, ecuria e kursit duhet parë si pasqyrë e suksesit në rritjen e eksporteve dhe jo si premisë e dështimit të tyre. Bazuar në këto premisa, mbiçmimi i kursit të këmbimit ka pasur një efekt tërësor pozitiv për ekonominë shqiptare. Ky efekt është materializuar në uljen e inflacionit, në ruajtjen e fuqisë blerëse dhe të vlerës së kursimeve të familjeve, si dhe në kosto më të ulëta financimi për ekonominë shqiptare. Po ashtu, mbiçmimi i kursit të këmbimit ka ndihmuar qëndrueshmërinë e stabilitetit financiar, nëpërmjet mbështetjes së bilanceve të kredimarrësve në valutë dhe efektit pozitiv në nivelin e kredive me probleme. Reagimi i Bankës së Shqipërisë ndaj zhvillimeve në kursin e këmbimit ka qenë dhe do të mbetet gjithnjë i orientuar nga respektimi i objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve dhe konsistent me regjimin e lirë të kursit të këmbimit të aplikuar në Shqipëri.

Në mbyllje të artikullit, theksohet se forcimi i kursit të këmbimit – i cili ka buruar nga një rritje e kërkesës së huaj për shërbime shqiptare – ka ndihmuar në kontrollin e inflacionit dhe ka mundësuar një normalizim më gradual të qëndrimit të politikës sonë monetare. Për pasojë, ai ka ndihmuar ruajtjen e fuqisë blerëse të familjeve dhe ka mbajtur të ulëta kostot e financimit të bizneseve dhe familjeve.

PREZANTIMET PËR MEDIAN TË RAPORTEVE PERIODIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Si pjesë e strategjisë së saj komunikimit me publikun, Banka e Shqipërisë organizon prezantimin e raporteve periodike për median përpara publikimit të tyre. Bazuar në kalendarin e publikimit të raporteve periodike të pasqyruar në faqen e internetit të Bankës

së Shqipërisë në fillim të vitit 2024, gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti janë zhvilluar 4 prezantime "off the records" për mediat:



- Prezantimi i Raportit tremujor të Politikës Monetare 2024/I, në datën 15 shkurt 2024, në ambientet e selisë nr.1 të Bankës së Shqipërisë;



- Prezantimi i Raportit të Stabilitetit Financiar 6M II 2023, në datën 30 prill 2024, në ambientet e selisë nr.1 të Bankës së Shqipërisë;



- Prezantimi i Raportit tremujor të Politikës Monetare, 2024/II, në datën 16 maj 2024, në ambientet e selisë nr.1 të Bankës së Shqipërisë;



- Prezantimi i Raportit Vjetor të Mbikëqyrjes për vitin 2023, në datën 27 qershor 2024, në ambientet e selisë nr.1 të Bankës së Shqipërisë.



SEMINARET E TË PREMTES

Banka e Shqipërisë organizon rregullisht aktivitetin me natyrë kërkimore "Seminari i të Premtes". Kjo nismë fton punonjësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare dhe kërkimore, të prezantojnë dhe të diskutojnë materialet e tyre kërkimore, teorike dhe empirike. Gjatë gjatshëmujorit të parë, më 12 qershor 2024, u prezantua punimi "Mediana e peshuar: Një matje e inflacionit bazë në Shqipëri", nga zj. Lorena Skufi, punonjëse e Bankës së Shqipërisë.

AKTIVITETET SOCIALE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë, në kuadër të përgjegjësisë sociale, ndërmerr vazhdimisht nisma të ndryshme humanitare.



Në datën 2 prill 2024, njësoj si vitet e kaluara, ndërtesa qendrore e Bankës së Shqipërisë u ndriçua në ngjyrë blu për të shënuar Ditën Botërore të Autizmit, si pjesë e një iniciative të përbashkët kombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit për të.



Gjatë kësaj periudhe, me rastin e 14 Qershorit "Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut", Banka e Shqipërisë iu bashkua nismës së dhurimit vullnetar të gjakut, ku disa prej punonjësve të saj dhuruan gjak, në ndihmë të pacientëve në nevojë.



**MJAFTOJNË VETËM
10 MINUTA
PËR TË SHPËTUAR
3 JETË**

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Fushatë për dhurimin e gjakut

